



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr. 80/2 Prot

Tiranë më 26/01/2023

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit; Organikës dhe Strukturës së Institucionit miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014, shpall 1(një) vend vakant për pozicionin e punës Orkestrant Kategoria e Dytë në Drejtorinë Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore.

❖ Orkestrant/e Kategoria e Dytë - 1 (një) vend (instrumenti Llahutë);

Për ti dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për ti krijuar mundësi pjesmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve TKOBAP nxjerrë njoftimin e saj 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Njoftojmë të gjithë të interesuarit se në datën 27/02/2023 ora 11:00 në Sallën e Orkestrës të Drejtorisë së Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore, në katin e katërt brenda ambienteve të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor do të zhvillohet audicioni për vendin vakant Orkestrant Kategoria e Dytë (instrumenti Llahutë) pranë Drejtorisë Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore.

Të gjithë ata artistë të jashtëm të interesuar për pjesmarrje për këto vende vakante duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP deri me datë 21/02/2023 ora 13:00 dokumentat e nevojshme për regjistrim si më poshtë vijon;

1. Të ketë kryer studimet e larta (bachelor ose mastër) pranë Universitetit të Arteve ose ekuivalente me to, për instrument;
2. Të demostroj që ka performuar ose është specializuar në llahut përgjatë koncerteve artistike ose masterklase të zhvilluara;
3. Diplomë e përfundimit të shkollës dhe listë notash të noterizuara;
4. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;
5. CV bashkangjitur me Foto;

1. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria e 2 viteve të fundit e certifikuar, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artistike, eksperiencë pune për pozicionin që konkurojnë, etj); Dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar këtë kriter.

Programi:

1. Ekzekutim i shkallëve Do maxhor dhe Sol maxhor (në dy oktava);
2. Ekzekutim i një partiture muzikore aprimavista (të dhënë nga komisioni në momentin e konkurimit);
3. Ekzekutim i një pjese solistike të zgjedhur nga vet konkurenti (jo më shumë se tre minuta);
4. Shoqërimi me orkestër i tre valleve me motive nga zona të ndryshme:
 - 1- Barinjtë e Korabit (Shqipëri e Veriut);
 - 2- Vallja e qypave (Shqipëri e mesme);
 - 3- Diell në fushë të Devollit (Shqipëri e jugut).
5. Shoqërimi me këngëtar i tre këngëve me motive nga zona të ndryshme:
 - 1- Eja eja Luleborë;
 - 2- O isha vetëm duke u mendu & Qënke veshur me të bardha;
 - 3- Hapi sytë e zezë.
6. Shpjegim teorik (nga ana e konkurentit) mbi instrumentin e LLahutës, teknikat, shtrirja, pozicionet, akordet.
7. Demonstrimi me instrument i ritmeve 2/4, 3/4, 4/4, 5/8, 7/8, 9/8, 12/8.

MIRATOI

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA

